



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.26/2018

Prishtinë, më 4 korrik 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Saranda Bogujevci, Luljeta Veselaj-Gutaj, Mexhide Mjaku-Topalli, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Munguan: Duda Balje, Sasha Milosavljeviç dhe Mirjeta Kalludra.

Stafi mbështetës i komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Minire Begaj, kryetare e Komisioni Qeveritar për pranimin dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale; Edi Gusia-ABGJ dhe Labinot Bala, Sekretaria e Komisionit Qeveritar për pranimin dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, zëvendëskryetare e parë e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Diskutim lidhur me ecurinë e procesit të verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale, si dhe ndarjes së pensioneve. Të ftuar: Komisioni Qeveritar për pranimin dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Agjencia për Barazi Gjinore;
2. Të ndryshme.

Lirije Kajtazi, tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi ftuar znj. Minire Begaj, kryesuese e Komisionit Qeveritar për pranimin dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale, znj. Feride Rushiti, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe znj. Edi Gusia nga Agjencia për Barazi Gjinore. Më pas, lidhur me këtë temë, hapi debat.

Minire Begaj, tha se komisioni është duke vepruar sipas Ligjit nr.04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054. Po ashtu, tha se për zbatimin e këtij ligji janë nxjerrë dy rregullore, vendimi për themelimin e komisionit qeveritar, vendimi për themelimin e Sekretarisë së Komisionit. Në Qeveri është miratuar vendimi për përcaktimin e lartësisë së pensionit personal për personat e dhunuar gjatë luftës, në vlerën 230 euro. Ajo tha se janë trajnuar 4 OJQ, që kanë për ta ndihmuar Komisionin gjatë procesit të aplikimit. Komisioni, në bashkëpunim me ABGJ-në, ka bërë informim publik nëpërmes billbordeve, në të gjitha qytetet e Kosovës dhe ka lansuar spotin televiziv për procesin e aplikimit, procedurës dhe mënyrës së aplikimit, po ashtu ka publikuar numrin e telefonit falas.

Më tej, tha se deri më dt. 29.6.2018, Sekretaria e Komisionit ka pranuar 599 aplikacione në nivel vendi, prej tyre janë shqyrtuar dhe trajtuar 218 lëndë, nga to 115 raste iu është njohur statusi i personave të dhunuar gjatë luftës, ndërsa 82 raste iu është refuzuar statusi.

Edi Gusia, tha se në vazhdimësi jemi të gatshëm të bashkëpunojmë, kur komisioni ka nevojë apo kërkon ndihmë nga ABGJ.

Feride Rushiti, tha se fatmirësisht, këtë vit, ka filluar kompensimi i dhunës seksuale të viktimave të luftës. Kjo nuk është diçka që e harron të kaluarën e tyre, por është thjesht njohje e vuajtjes së këtyre grave dhe burrave që kanë përjetuar në atë periudhë. Po ashtu, tha se ky proces ka pasur shumë sfida dhe jemi munduar që procesin të ndajmë prej qasjes në drejtësi.

Labint Bala, tha se palëve që drejtohen te ne, iu kemi ofruar ndihmë gjatë aplikimit, bëjmë mbledhjen e aplikacioneve nga terreni dhe OJQ-të, kemi qenë pjesë e procesit edhe të sistemit

të pagesave. Pra, sekretaria është një organ administrativ i procesit, duke filluar prej pranimit të aplikacioneve e deri në procesin e pagesës.

Lirije Kajtazi, theksoi se nga të gjitha aplikimet që i kishit, u tha se janë 82 refuzime. A mendoni se këta kanë ardhur vetëm për t'ju vënë në lajthitje apo për çfarë arsye? Kemi pasur një ankesë nga një OJQ, pse nuk është licencuar dhe kemi marrë një përgjigje me shkrim për këtë.

Ajo tha se ka kërkuar nga IAP, që në raportet e OKB-së të përfshihet dhe të përmendet kjo dhunë që ka ndodhur.

Saranda Bogujevci, tha se më intereson të di se në çka bazoheni, kur i refuzoni aplikacionet, a ka mekanizma të caktuar për njohjen dhe verifikimin e statusit dhe a ka ndonjë mekanizëm që

e monitoron punën e komisionit? Kam informata se po vonohet lëshimi i vendimit, cila është përbërja e anëtarëve të komisionit? Mendoj se te forma e aplikimit është dashur të jetë e incizuar dhe të nxirret transkriptit. Më pas, pyeti: Kur plotësohet ky formular, kush është prezent me atë person?

Mexhide Mjaku-Topalli, theksoi se me sa kam informata, ju nuk i takoni direkt. U tha se aplikacionet mblidhen nga katër organizatat që i keni licencuar dhe nga zyrtarët nëpër komuna dhe prej aty i merreni dhe i trajtoni këto aplikacione. A i takoni ju këta persona që aplikojnë në këto organizata dhe nëpër komuna? Këta persona, derisa intervistohen, a iu ofrohen shërbime psikologjike, që krahas pensionit, t'iu mundësohet edhe trajtimi me psikologe apo psikiatër. E kemi pasur në takim z. Mustafë Prenku, i cili është ankuar se nuk është licencuar dhe thotë se ai i ka listat nga UNMIK-u, lista që nuk i ka askush dhe po më intereson të di pse nuk është licencuar?

Fisnik Ismaili, tha se me atë që dëgjon po ndihet optimist se më në fund po lëviz diçka për së miri. Ai u interesua të dijë se sa është numri i saktë i viktimave, flitet se është 20000 mijë, por faktikisht është më i ulët, por nuk është shumë më i ulët. Ai tha se më shumë është i interesuar që të identifikohen rastet dhe të ndiqen ligjërisht, duhet gjetur formën se qysh është mënyra që të kontaktohen direkt këta persona dhe të identifikohen ata, të shkohet në komunitet, në familje, për t'ua treguar rëndësinë e këtij procesi.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se u potencua se në përbërje të komisionit dominojnë juristët, por mendoj se më shumë duhet të ketë ekspertë të fushave sociale. A ka qenë kriter që në përbërje të komisionit të dominojnë juristët? Në ato raste që atë person nuk e pranon as familja, sepse ka raste të tilla, cilat janë shërbimet që i merr, ku jeton, kush e mbështet? Më e rëndësishmja e gjithë kësaj është që pas gjithë këtyre viteve, mendoj se ata që e kanë shkaktuar këtë duhet t'u jepet dënimi i merituar, sepse asgjë s'e bën që të ndihet mirë personin sesa dënimi i atyre që e kanë shkaktuar.

Shemsi Syla, tha se femra shqiptare sikur është lënë mbas dore dhe sikur nuk është trajtuar siç duhet. Pra, duhet bërë edhe më shumë në atë drejtim, që të aktivizohen femrat që të jenë aktive për të dëshmuar, sepse kjo është një histori prej më të dhimbshmeve që kemi kaluar, por në një mënyrë është edhe një satisfaksion që ngrit meritat e jashtëzakonshme që ka pasur femra shqiptare në periudha të ndryshme. Është mirë që ne, si komision, të mendojmë dhe të kontribuojmë me idetë, në mënyrë që të vijë deri tek ajo që më shumë persona të deklarohen dhe të aplikojnë dhe të identifikohen rastet.

Lirije Kajtazi, u interesua se prej cilës kohë kanë filluar t'i marrin kompensimet. Sa i përket mënyrës retroaktive, prej cilës kohë mendoni se do të kishte qenë më mirë t'i marrin?

Feride Rushiti, tha se në raport me numrat, jo vetëm në Kosovë, por në asnjë vend të botës nuk ka statistika të sakta. Në Kosovë është përdorur një referencë nga një studim i bërë nga SDSI-a dhe është bërë në korrik-gusht të vitit 1999, me qëllim të matjes së nivelit të traumës në popullatë. Pjesë e atij pyetësi kanë qenë pyetjet se kush ka qenë e dhunuar dhe a ka qenë dëshmitar gjatë dhunimit, dhe mostra reprezentative e Kosovës, që është diku 1350 persona, përafërsisht ka dalë 4.4 %, që kur e shumëzoni me numrin e përgjithshëm, del rreth 20 000 veta, përndryshe në tërë botën kështu nxirren të dhënat.

Sa i përket qasjes në drejtësi, janë mbledhur dëshmi të panumërta dhe ka ndodhur që gratë kanë dëshmuar 30 herë në UNMIK, para kamerave, pastaj kanë shkuar në Tribunal të Hagës, e pastaj ka ardhur EULEX-i dhe s'i ka njohur dëshmitë e UNMIK-ut, dhe kështu ka filluar procedura prej fillimit. Kjo ka ndikuar negativisht tek ata persona që janë lodhur duke dhënë deklarata të panumërta dhe tani thonë se drejtësi për ta asnjëherë nuk do të ketë. Për viktimat e dhunës seksuale nuk ka pasur standarde të veprimit dhe tani bashkërisht me Policinë e Kosovës, me Prokurorinë e Shtetit, Prokurorinë Speciale për krime lufte, jemi duke i ndërtuar procedurat standarde të veprimit për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës. Është mirë që të rritet presioni

dhe të hapen dosjet për të gjitha dëshmitë që janë mbledhur në kohën e UNMIK-ut, sepse atëherë kanë qenë të freskëta dhe ato ekzistojnë, nuk kanë humbur.

Minire Begaj, tha se ne nuk guxojmë të mendojmë se kush aplikon e ka qëllimin e keqpërdorimit. Pra, secili aplikacion që vjen, e trajtojmë, kërkojmë dokumente mbështetëse shtesë. Mbi këtë bazë, ligji na ka lejuar që kur komisioni vlerëson se ka nevojë për të kontaktuar me palën, na lejohet një gjë e tillë, por edhe palës i lejohet të deklarohet para komisionit. Deri tani, kemi pasur 8 panele. Panelet janë me nga tre anëtarë. Komisioni, sipas ligjit, përbëhet nga 9 anëtarë: përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, e Ministria e Drejtësisë, Instituti për Krime Luftë, dhe 4 të tjerë, që janë: një jurist prej shoqërisë civile, një psikolog dhe një psikiatër klinik, që kanë kaluar përmes konkursit publik. Domethënë, nuk janë të gjithë juristë, dhe i vetmi Komision për njohjen dhe verifikimin e statusit të dhunës seksuale, është ky komision. Nuk ka mekanizëm të monitorimit të komisionit, por në këtë komision bën pjesë edhe shoqëria civile, e cila në njëfarë forme, e bën monitorimin e procesit. Sa i përket incizimit të deklaratave apo dëshmimeve, ajo tha se është një organ administrativ dhe thuajse është një punë e rëndë, por të gjitha ato punë kryhen në detaje, sepse në aplikacion është çdo detaj, mandej kemi dokumentet shtesë dhe e plotëson. Ne, në bazë të kësaj, po mundohemi që gjithçka të vendoset në procesverbal dhe të mbetet aty, që më vonë, nëse hapet procesi i drejtësisë. Komisioni i ka pranuar rastet mbi bazën e asaj lënde dhe secila lëndë e ka kodin dhe se kjo bëhet konform ligjit dhe nuk na lejohet të bëjmë transkript. Ishte një pyetje se a i takoni viktimat e OJQ-së, kjo bëhet varësisht prej kërkesës dhe nuk kemi dallim këtu dhe nëse e vlerësojmë se duhet takuar ndonjë person, atëherë e takojmë.

Edi Gusia, tha se sa i përket fuqizimit ekonomik të gruas, është shumë e vërtetë që është punuar shumë pak, sepse procesi ka qenë shumë i ngadalshëm. Si agjenci i ndihmojmë organizatat joqeveritare, vetëm përmes subvencioneve. Sa i perfekt shifrës, se a kanë qenë 15 apo 20 mijë, nuk do ta kuptojmë asnjëherë, sepse nuk e ka kuptuar askush në shtete para neve, atje ku kanë ndodhur dhunimet dhe nuk do ta kuptojmë as ne, derisa nuk ia japim historisë sonë shtetërore një perspektivë të grave, derisa ne nuk i mësojmë fëmijët nëpër shkolla se perspektiva e atyre grave është perspektiva e ndërtimit të lirisë dhe humbja e atyre është kontribut dhe sakrificë për lirinë. Sa i përket reparacionit duhet ta kuptojmë se reparacion nuk jep shteti, i cili ka përjetuar dëmin, por reparacionin e jep shteti i cili e ka shkaktuar dëmin.

Feride Rushiti, tha se në raportin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që ka dalë në prill, fatkeqësisht Kosova nuk përfshihet fare, edhe pse ne i kemi këtu të gjitha agjencitë e Kombeve të Bashkuara, por prapëseprapë nuk përfshihemi, për këtë kemi

reaguar ne, ka reaguar edhe Konsullata e Kosovës në Nju-Jork, si dhe ambasadorja e Kosovës në Uashington.

Lirije Kajtazi, njoftoi se për shkak të angazhimeve, tani iu bashkëngjitën komisionit edhe dy anëtare të komisionit, por se shumëçka u tha dhe shpreson që mos të kthehen mbrapa dhe ato pyetje që u janë përgjigjur mos të ndaleni, por i marrin përgjigjet nga procesverbali.

Saranda Bogujevci, tha se a ka pasur raste kur është refuzuar kërkesa në bazë të aplikacionit dhe a janë ftuar në intervistë para se të ndodhë refuzimi, dhe prapë mendoj se duhet pasur një farë lloj monitorimi të performancës së punës së komisionit, se kujt i raportoni si komision.

Minire Begaj, tha se me ligj është lejuar që të kemi raporte periodike, ndërsa i raportojmë Qeverisë lidhur me procesin, por edhe sipas kërkesës, që cilido institucion e kërkon, por nuk japim të dhëna të tjera. Ai që nuk është i kënaqur dhe se ka prova se që të gjithë ata që jemi në proces nuk jemi duke e bërë punën siç duhet dhe jemi duke bërë shkelje në këto parime, mund t'iu drejtohet institucioneve hetuese.

Teuta Haxhiu, tha se në komision ka qenë një person që ka një organizatë dhe është ankuar që nuk është licencuar. Ne iu jemi drejtuar edhe juve, por shqetësim është që ai ka deklaruar se ka diku rreth 400 apo 500 raste, dhe se vetëm ai është personi përgjegjës që mund t'i paraqesë, përndryshe ato gra nuk e kanë autorizuar dikë tjetër. A ekziston kjo mundësi që ato gra me qenë peng i atij personi? Është përmendur dje në Drenas se janë 100 raste që janë refuzuar dhe nga këto 100 raste, a kanë të bëjnë me këto organizatat e licencuara? Po ashtu, në fund pyeti: Ata persona a kanë mundësi të bëjnë aplikimin vetë, pa organizatën?

Minire Begaj, tha se sa i përket Mustafë Prenkut, kemi paraqitur një raport, nuk kam kompetencë për të folur, për të për shkak se procesi i licencimit nuk ka shkuar përmes këtij komisionit, por ka qenë një komision qeveritar. Procesi dhe asnjë lëndë nuk guxojnë të jenë peng i dikujt. Aplikimi është aq i thjeshtë dhe i lehtë, sa që nuk nevojitet as staf profesional dhe nuk do të lejojmë që këtë proces ta keqpërdor askush, sepse është proces shtetëror. Ligji lejon të bëhen ndjekje, hetime. Edhe lëndët e Mustafë Prenkut, janë duke u trajtuar. Ne i trajtojmë rastet individuale, të paraqitura. Ajo tha se secila palë ka nevojë vetëm të vijë deri te sekretaria për të aplikuar dhe nuk ka nevojë fare për organizatën. Është shumë me interes që të nxiten dhe të inkurajohen palët për deklarata dhe kjo është shumë sfiduese.

Shemsi Sylja, tha se mijëra fakte dhe fotografi ia kemi dërguar UNMIK-ut, dhe sot nuk e dimë se ku janë. Dhe, krahas Serbisë që duhet t'i bëhet padi, duhet t'i bëhet padi edhe UNMIK-ut dhe EULEX-it për fshehje të fakteve dhe nuk duhet të heshtim asnjëherë dhe të ngremë zërin krahas saj, sepse kanë bërë krimin e dytë ndaj të vërtetës.

Minire Begaj, tha se te dokumentimi se në kuadër të misionëve të OKB-së janë 90 mijë faqe apo 900 mijë faqe në Tribunal të Hagës, dhe ne si Kosovë, për një kohë shumë të shkurtër nuk arrijmë të kushtëzojmë për t'i pasur ato dokumente, sepse është standard ndërkombëtar që OKB-ja, pas një kohe i asgjëson, dhe nëse nuk mund t'i marrim ato, atëherë ne nuk mund të mbrojmë krejt atë që është bërë, për ta dokumentuar te gjeneratat, sepse ato mund t'i zhdukin. Ato janë diku, nuk guxojmë të themi që nuk janë, sepse UNMIK-u, disa i ka fshehur e disa i ka dërguar në Serbi, për rrethana të tjera, por shteti duhet t'i kërkojë ato dokumente dhe t'i paraqesë në hetuesinë e shtetit tonë.

3. Të ndryshme.

Nuk pati tema për diskutim në këtë pikë të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje